VENDIM

Nr. 777, datë 17.12.1998

PËR DHËNIE FONDESH PËR KRYERJEN E PAGESAVE DHE SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të ligjit nr. 8283, datë 3.2.1998, "Për buxhetin e shtetit për vitin 1998", me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, në zërin "paga", i shtohen 15 milionë lekë. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

2. Në buxhetin e shtetit të miratuar për vitin 1998 për Ministrinë e Mbrojtjes, shuma prej 10 milionë lekësh parashikuar në zërin "shpenzime operative", të kalojë në zërin "paga".

3. Në buxhetin e shtetit të miratuar për vitin 1998 për Ministrinë e Mbrojtjes, shuma prej 35 milionë lekësh e fondeve të kushtëzuara në zërin "shpenzime operative", të përdoret për të mbuluar pagat e punonjësve të ushtrisë, pagesat për kohën e qëndrimit të tyre në gatishmëri, për kryerjen e shpërblimeve si rezultat i privacioneve dhe vështirësive në kryerjen e detyrave të ngarkuara.

4. Kriteret dhe masat e shpërblimeve të përcaktohen nga ministri i Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko